

AMNISTIA FISKALE

MINISTRI

FMN jep OK për amnistinë. Ministri: Do të ndiqet modeli i Kosovës

# Ahmetaj konfirmon amnistinë Ja detyrimet që do të falen

Falen detyrimet para 2010, kushti për gjambat deri në 2014

DORINA AZO

Me rishikimin e draftit të amnistiës, biznesit do t'i falen pa kusht detyrimet e krijuara deri më 31 dhjetor të 2010-s.

Amnistia me kushte do të përfshijë faljen e gjobave dhe kamatëvonesave për periudhën nga 1 janari 2011 deri më 31 dhjetor 2014, vetëm nëse paguhet detyrimi principal. Ministri i Financave, Arben Ahmetaj, shpjegoi dje për herë të parë ndryshimet që do të bëhen në amnistisë fiskale pas përfundimit të bisedimeve në Uashington me Fondin Monetar Ndërkombëtar. Ministri Ahmetaj konfirmoi se është rënë dakord me FMN-në të ndiqet modeli i Kosovës për faljen e detyrimeve të biznesit. Ministri Ahmetaj dha këto detaje mbi draftin e ri. "Do të jetë një fshirje, sipas traditës së fshirjes së borxheve deri më 31 dhjetor të 2010-s, ndërsa nga janari i vitit 2011 deri në dhjetor të vitit 2014 do të përdorim instrumentin pak a shumë që Fondi Monetar Ndërkombëtar ka lejuar të përdoret në Kosovë, që

**AMNISTIA PËR BIZNESIN**

- Do të falen pa kusht detyrimet e biznesit të krijuara në Tatime dhe Dogana deri në periudhën 31 dhjetor 2010
- Do të falen gjambat dhe kamatëvonesat e krijuara nga mospagimi i detyrimeve të biznesit në Tatime e Dogana për periudhën nga 1 janari 2011 deri më 31 dhjetor 2014, vetëm nëse paguhet detyrimi principal



Ministri i Financave, Arben Ahmetaj

është një lloj incentive, ku nëse paguhet detyrimi principal, të hiqen interesat dhe gjambat, por për periudhën deri më 31 dhjetor 2014. Kjo është një metodologji e përdorur në Kosovë dhe është hera e fundit që përdoret,

meqë kemi kaluar në një nivel të dytë më të avancuar të betejës antiinformalitet. Nëse nuk e paguan, automatikisht je objekt i mbledhjes së detyrimit me forcë. Për vitin 2015, për vitin 2016 asnjë gjë nuk ndryshon dety-

rimet e vëna, interesat e kalkuluara të gjitha do të mbledhen me ligj", u shpreh Ahmetaj. Në draftin paraprak të amnistiës fiskale përfshihen edhe çregjistrimi i 100 mijë makinave dhe shuarja e detyrimeve të papaguara,

për të cilat nuk është kryer asnjë veprim deri në dhjetor 2011. Ministri i Financave, Ahmetaj, shprehu rezervat për faljen e detyrimeve të papaguara nga 100 mijë drejtues të automjeteve, duke dhënë këtë shpjegim. "Jemi

duke folur për atë pjesë që kemi rënë dakord me Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe shumë shpejt do ta kemi dhe në publik të shkruar. Kur të shkruhet përfundimisht, do ta shikoni", u shpreh Ahmetaj.

**DISKUTIMET ME FMN**  
Këtë javë në Tiranë pritet të mbërrijë edhe misioni i Fondit Monetar Ndërkombëtar. Ministri i Financave, Arben Ahmetaj, shpjegoi se në fokus të diskutimeve do të jetë buxheti i vitit të ardhshëm dhe financimi i reformave. Për rishikimin e marrëveshjes me FMN-në, Ahmetaj theksoi se bashkëpunimi do të vazhdojë. "Ne jemi në marrëveshje akoma edhe 2 muaj deri në fund të këtij viti me Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe rishikimi i fundit bëhet në muajin shkurt të 2017-s. Do të diskutohet gjithë platforma normale që nga pjesa makroekonomike fiskale, buxheti i vitit 2016, pritishtëritë e draft-buxhetit 2017, politikat fiskale dhe financimi i reformave. Ne kemi vendosur që të kemi një marrëdhënie shumë të mirë me FMN-në", u shpreh Ahmetaj.




## SiCRED- 8 mujori - e vetmja me rritje nga shoqëritë e sigurimit të Jetës, dëmshpërblen me 105.000 Euro pilotët e rënë në krye të detyrës

2016 -Viti i Sigurimit të Jetës dhe Kursimit –SiCRED me fokus te produktet financiare


Shoqëria e Sigurimit të Jetës SiCRED sh.a., ka dëmshpërbler familjarët e dy pilotëve të rënë në detyrë, sipas marrëveshjes siguruese me Ministrinë e Mbrojtjes. Në datën 6 prill 2016, helikopteri i forcave të armatosura në të cilin udhëtonin 3 ushtarakë është rrëzuar në liqenin e Shkodrës, duke u marrë jetën 2 pilotëve.

Dy pilotët rezultuan të siguar, sipas Kontratës së Sigurimit "Për Sigurimin e jetës së efektivit fluturues", të lidhur midis Ministrisë së Mbrojtjes dhe Bashkimit të Operatorëve. Bazuar në këtë kontratë, SiCRED sh.a. ka paguar shumën prej 14.4 milion lekë në favor të familjarëve të ushtarakëve të rënë. Kjo është hera e parë që SiCRED sh.a. bën një pagesë e tillë për pjesëtarët e Forcave të Armatosura që humbin jetën në krye të detyrës, duke qenë pranë familjarëve të ushtarakëve, për të lehtësuar mungesën e thellë të lënë pas nga ndarja e parakohshme nga jeta e të dashurve të tyre.



**SICRED RRETH 25% TË TREGUT E SIGURIMIT TË JETËS NË MBYLLJE TË 8-MUJORIT**  
SiCRED ka patur një aktivitet të suksesshëm gjatë vitit 2016. Krahasuar me 8-mujorin e vitit 2015, vetëm SiCRED pati rritje të primeve të shkruara në tregun e sigurimit të jetës, me një rritje të vëllimit të primeve të shkruara bruto prej 7.3%.  
Kjo performancë pozitive ka rezultuar dhe në përmirësimin e pjesës së tregut të SiCRED, e

cila ka arritur në 25%, krahasuar me 22% të së njëjtës periudhë të vitit 2015.  
**PRODUKTE SIGURIMI PËR PËRFITIMEVE FINANCIARE AFATGJATA**  
Misioni i SiCRED është të jetë partneri kryesor financiar për individin, duke e shoqëruar atë përgjatë gjithë jetës, nëpërmjet ofrimit të produkteve të sigurimit të përshatshme me kërkesat dhe nevojat e individit në çdo fazë të jetës së tij. Gjatë vitit 2016, Si-



CRED është fokusuar në ofrimin e produkteve të sigurimit me element kursimi afatgjatë, të cilat i mundësojnë të siguarit përfitime dyfish: sigurim dhe kursim.  
Sigurimi i Jetës (me Mbi-jetesë), i prezantuar vetëm pak muaj më parë nga SiCRED, garanton për të siguarin një shumë monetare (Shuma e siguruar) e cila është e pagueshme në rast vdekje apo mbijetesë. Bashkë me këtë sigurim, individit mund të zgjedhë dhe sigurimet shtesë nga aksidentet dhe sëmundjet kritike.

SiCRED është e para kompani sigurimi në treg që ofron kombinimin e sigurimit të jetës afatgjatë me element kursimi me sigurimin nga sëmundjet kritike, një sigurim i cili i ofron të siguarit një shumë monetare në rast të shfaqjes së një prej sëmundjeve kritike (sëmundje të rënda), gjatë periudhës së sigurimit. Kështu, i siguarit do të ketë të ardhura të mjaftueshme për të përballuar kurimin e tij, pa vënë në rrezik planet e tjera financiare të familjes.  
Në Sigurimin e Jetës (me Mbi-jetesë), pjesa e primit të sigurimit që

kursethet rregullisht, investohet me një normë minimale të garantuar prej 1.2%. Në një kohë kur depozitat në monedhë të rënda si Euro apo Dollarë Amerikanë, kanë një normë interesi pothuaj 0% e në disa raste edhe negative, ky produkt paraqet një alternativë shumë të mirë investimi afatgjatë. Gjithashtu, produkti i sigurimit i jep të drejtën individit të marrë pjesë dhe në fitimin e realizuar nga kompania për portofolin e këtij produkti, duke maksimizuar përfitimet e individit nga ky sigurim. Këto produkte sigurimi ju ndihmojnë të jetoni sot më të qetë dhe të lumtur dhe të ndërtoni të ardhmen tuaj ashtu siç ju e imagjini. Duke investuar shumën të vogla sot në formën e primit të sigurimit, produkti i sigurimit mundëson të keni një shumë të madhe parash nesër, pikërisht atëherë kur ju nevojitet.  
SiCRED garanton klientët e saj së në vijim do të ndërmarrë fushata edukimi intensive nëpërmjet burimeve të saja për edukimin e konsumatorit shqiptar në lidhje me përfitimet që klientët e saj kanë nga produktet e Sigurimit, e veçanërisht produktet financiare.